



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 20, datë 23.05.2016

**Për
“PAGESËN E KUOTËS SË ANËTARËSISË SË BASHKISË SË TIRANËS
NË SHOQATËN PËR “AUTONOMI VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 të Ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 për “Ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”; nenit 8, nenit 121, pika 1, nenit 122, pika 2, nenit 124, pika 1, nenit 125, nenit 126 të Ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.5, shkronja “c”, nenit 40, pika 1, nenit 54, shkronjat “dh” dhe “gj”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, shkresa nr.prot.1, datë 27.01.2016 e Shoqatës për “Autonominë Vendore” (protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr.prot. 2774, datë 28.01.2016 “Kërkesë për pagesën e kuotës së anëtarësisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën vjetore të kuotës së anëtarësisë së Bashkisë së Tiranës në Shoqatën për “Autonomi Vendore”, për vitin 2016 e në vijim, në masën prej 10.000 (dhjetëmijë) lekë në vit, për çdo 1.000 (njëmijë) banorë.
2. Fondi vjetor të përlogaritet bazuar në të dhënat zyrtare në dispozicion mbi numrin e popullsisë të vitit korrent dhe të miratohet në buxhetin e vitit përkatës.
3. Për vitin 2016, fondi prej 6.000.000 lekë, do të përballohet nga buxheti i aparatit të Bashkisë, në programin e administratës vendore për kuota anëtarësie.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.22, datë 18.07.2012 për “Pagesën e Kuotës së Anëtarësisë së Bashkisë së Tiranës në Shoqatën e “Bashkive të Shqipërisë”, revokohet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI